

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË JETËS NË RAST VDEKJEJE DHE MBIJETESE

I. PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Këto kushte të përgjithshme për sigurimin e jetës në rast vdekjeje dhe mbijetese (këtu e më poshtë do të quhen "Kushte të Përgjithshme" rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet palëve në kontratën e sigurimit të jetës.

2. Kushtet e përgjithshme të sigurimit të jetës janë pjesë përbërëse Kontratës së Sigurimit që Kontraktuesi/I Siguruarit lidh me Shoqërinë e Sigurimeve SIGAL (këtu e më poshtë do të quhet sigurosi).

Përcaktime të përgjithshme

Neni 2

Në këto kushte të përgjithshme termat e përdorur kanë kuptimin e mëposhtëm:

Sigurosi: Shoqëria e sigurimit me të cilën lidhet një kontratë sigurimi dhe e cila do t'i paguajë përfituesit përfitimet e përcaktuara në kontratën e sigurimit;

Kërkesë: Paraqitje me shkrim e interesit të kërkuarit në adresë të sigurosit për lidhjen e një kontrate sigurimi;

Kontraktues: Personi fizik ose juridik që lidh kontratën e sigurimit me sigurosin.

I Siguruar: Personi fizik jeta e të cilit sigurohet dhe me mbijetesën ose vdekjen e të cilit lidhet pagesa e shumës së Sigurimit për të cilën është rënë dakord.

Përfitues: Personi fizik që përfiton shumën e rënë dakord në kontratë.

Policë e sigurimit: Dokumenti që vërteton lidhjen e kontratës së sigurimit të jetës.

Prim i Sigurimit: Shuma të cilën i sigurosi/kontraktuesi është i detyruar t'i paguajë Sigurosit në bazë të kontratës për Sigurimin e jetës.

Periudha e sigurimit: Kohëzgjatja e kontratës së sigurimit.

Periudha e Pagesës së Primit: Periudha gjatë së cilës paguhen primet. Është e përcaktuar në kërkesën për sigurim. Kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se periudha e sigurimit.

Ngjarja e Sigurimit: Ngjarje e ardhshme, e cila është e pavarur nga vullneti i të siguarit. Një ngjarje e tillë është vdekja e papritur e të siguarit brenda periudhës së sigurimit apo mbijetesa e këtij të fundit deri në përfundim të periudhës së sigurimit.

Shuma e sigurimit: Shuma e rënë dakord për të cilën lind detyrimi i sigurosit i përcaktuar me kontratën e sigurimit/policën e sigurimit.

Shuma e kapitalizuar: Shuma që sigurosi do t'i japë të siguarit, në përfundim të periudhës së sigurimit, në rast se i sigurosi e ndërpret kontratën e sigurimit dhe nuk e tërheq vlerën e primeve të paguara.

Vlera e Primit të Kthyer: Shuma që sigurosi do t'i kthejë kontraktuesit/të siguarit në rast përfundimi të parakohshëm të kontratës së sigurimit.

Rezerva matematikore: Vlera aktuale e detyrimeve të ardhshme të sigurosit pasi janë zbritur vlera aktuale e detyrimeve të ardhshme të të siguarit.

Neni 3

1. Kontraktuesi/I Siguruarit i paguan sigurosit primin dhe sigurosi, nëse ndodh ngjarja e sigurimit, i paguan përfituesit shumën e siguruar ose një pjesë të saj sipas kontratës.

2. Sigurimi i jetës në rast vdekjeje apo mbijetese mund të kryhet me ose pa kontroll mjekësor.

3. Përveç sigurimit të jetës në këtë kontratë mund të ofrohen edhe sigurime shtesë sipas kushteve shtesë të sigurosit.

4. Sipas këtyre kushteve të përgjithshme kufiri minimal dhe maksimal i moshës së personave të sigurueshëm është 18 – 65 vjeç. Sigurimi përfundon kur i sigurosi arrin moshën 65 vjeç. Personat të cilët në momentin e aplikimit kanë probleme shëndetësorë mund të sigurohen në përputhje me kushtet e veçanta të rreziqeve të rritura (rrezik jonormal) në sigurimin e jetës ose mund të refuzohet kërkesa e tyre për sigurim. Personat e paaftë për punë nuk mund të sigurohen.

5. Të gjitha njoftimet, deklaratimet dhe kërkesat e palëve kontraktuese duhet të paraqiten me shkrim dhe të respektojnë kushtet e përgjithshme të sigurimit.

6. Në rastet e dërgimit të dokumentacionit me postë, si datë e marrjes për secilën palë kontraktuese do të konsiderohet data e vullës postare.

II. LIDHJA E NJË KONTRATE SIGURIMI

Kërkesa

Neni 4

1. Për lidhjen e kontratës së sigurimit të jetës, kontraktuesi/i sigurosi duhet të paraqesë kërkesën për sigurim në adresë të sigurosit. Kërkesa duhet të plotësohet tërësisht, me vërtetësi, saktësi, dhe në të duhet të shënohen të gjitha faktet me rëndësi për marrjen në sigurim dhe lidhjen e kontratës. Sigurosi ka të drejtë që, në rast se e gjykon të arsyeshëm, t'i kërkojë të siguarit të kryej kontrollin mjekësor sipas procedurave të tij.

2. Sigurosi ka të drejtë që, brenda një periudhe kohore minimumi 15 ditë nga dita e marrjes në dorëzim të kërkesës për sigurim, të bëjë vlerësimin e rrezikut dhe të marrë një vendim për pranimin ose refuzimin e kërkesës për sigurim.

3. Kontraktuesi si dhe vetë i sigurosi janë të detyruar që të njoftojnë me shkrim sigurosit nëse gjatë periudhës nga plotësimi i kërkesës për sigurim deri në lidhjen e kontratës ka

ndodhur rritje e rrezikshmërisë për shëndetin ose jetën e të siguarit, siç është shfaqja e një sëmundjeje më të rëndë ose plagosja, dëmtimi i të siguarit, ndryshimi i profesionit ose ushtrimi i sporteve të rrezikshme.

4. Sigurosi gëzon të drejtën që të refuzojë kërkesën për sigurim pa dhënë sqarim për shkaqet e refuzimit të kërkesës, ndërsa kërkesa me dokumentacionin e paraqitur, përveç dokumenteve të dorëzuara në origjinal, nuk i kthehen të siguarit/kontraktuesit.

5. Kërkesa është një pjesë thelbësore e kontratës së sigurimit dhe duhet të nënshkruhet nga të dyja palët. Nëse kontraktuesi dhe i sigurosi nuk janë i njëjti person atëherë është e nevojshme edhe firma e të siguarit që kontrata të konsiderohet e vlefshme.

6. Nëse sigurosi njofton kërkuarin për kushte të veçanta që duhen plotësuar nga ana e tij dhe kërkuari nuk bie dakord me këto kushte brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit, atëherë do të konsiderohet se kërkuari e ka tërhequr kërkesën.

7. Pas nënshkrimit të kërkesës së sigurimit, sigurosi lëshon policën e sigurimit dhe ia dërgon kontraktuesit/te siguarit me postë. Kërkesa për sigurim, pyetësi shëndetësor i plotësuar me të dhënat e të siguarit, raporti mjekësor, rezultatet e kontrollit mjekësor, policja e sigurimit, kushtet e përgjithshme si dhe shtojcat (nëse ka) janë pjesë përbërëse thelbësore e kontratës së sigurimit.

Polica e sigurimit

Neni 5

1. Sigurosi lëshon Policën e Sigurimit si një dokument që vërteton lidhjen e kontratës së sigurimit. Bashkë me Policën e Sigurimit, sigurosi lëshon për të siguarin edhe Kartën Personale të Sigurimit.

2. Polica e Sigurimit është e vlefshme për personat e përcaktuar në të "i sigurosi" apo "përfitues" ose për personat e caktuar me akt juridik për të e paraqitur atë dhe jo për çdo person që e paraqet. Në çdo rast, paraqitja e policës së sigurimit do të shoqërohet me paraqitjen e kartës personale të sigurimit.

3. Nënshkrimet e kontraktuesit dhe të të siguarit në kërkesën për sigurim do të pranohen si nënshkrime të vlefshme në policën e sigurimit.

4. Polica për sigurimin e jetës përmban të dhënat e plota të sigurosit: emër, mbiemër, adresën e të siguarit, datëlindjen, llojin e mbulimit, fillimin dhe përfundimin e periudhës së sigurimit, shumën e sigurimit, primin e sigurimit, datën e pagesës së tij, përfituesin në rast vdekjeje ose mbijetese, dhe datën e lëshimit të policës. Karta e Sigurimit përmban një numër serik, numrin e policës së sigurimit, afatin e përfundimit të sigurimit si edhe identitetin e personit të siguarit të shoqëruar me fotografi.

5. Polica e sigurimit do të përmbajë domosdoshmërisht edhe tabelën e vlerave të primit të kthyeshem si dhe tabelën e shumës së kapitalizuar.

6. Nëse bashkë me sigurimin e jetës është rënë dakord edhe për sigurime shtesë, pjesë përbërëse të kontratës së sigurimit do të jenë edhe kushtet shtesë të sigurosit për sigurimin shtesë përkatës.

7. Polica e jetës lëshohet në një kopje të vetme origjinale.

III. VLEFSHMËRIA E KONTRATËS SE SIGURIMIT

Neni 6

1. Kontrata e sigurimit të jetës lidhet për një afat kohor të paracaktuar.

2. Kontrata e Sigurimit të Jetës hyn në fuqi në orën 00.00 të ditës së parë të fillimit të mbulimit të shënuar në policë.

3. Detyrimet e sigurosit fillojnë nga data e fillimit të sigurimit sipas paragrafit (2) të këtij neni vetëm nëse deri në atë ditë është paguar primi i parë ose kësti i parë i tij.

4. Nëse primi i parë ose kësti i parë i tij nuk është paguar deri në datën e fillimit të sigurimit ose brenda afatit të rënë dakord, detyrimet e sigurosit fillojnë në orën 24:00 të ditës kur primi i rënë dakord do të paguhet i plotë, por jo më parë se data e fillimit të sigurimit.

5. Detyrimi i sigurosit zgjat deri në orën 24.00 të ditës së shënuar në policë si ditë e përfundimit të sigurimit. Detyrimi i sigurosit do të përfundojë pas përmbushjes së përgjegjësisë së caktuar gjatë periudhës së sigurimit.

IV. PRIMI DHE SHUMA E SIGURIMIT

Neni 7

1. Sigurosi përcakton primin e sigurimit vjetor bazuar në moshën, gjininë e të siguarit, shumën e siguruar, periudhën e sigurimit dhe kushtet e tjera të përcaktuara nga sigurosi e të pasqyruara në manualin përkatës të primeve.

2. Primi i parë ose kësti i parë i tij, duhet të paguhet përpara fillimit të periudhës së sigurimit të përcaktuar në policë, që në momentin e nënshkrimit të Kërkesës për Sigurim.

3. Pas fillimit të sigurimit, primi i sigurimit do të paguhet çdo vit brenda së njëjtës datë të vitit pasardhës ose në këste të barabartë gjatë vitit dhe në vazhdim.

4. Primi i sigurimit paguhet në monedhën në të cilën është shprehur shuma e sigurimit.

5. Nëse i sigurosi vdes pa paguar primin e sigurimit për vitin përkatës si pasojë e mosrespektimit të afateve të përcaktuara sipas këtyre kushteve, atëherë sigurosi do të e zbrisë primin/primet e papaguar nga përfitimi i pagueshëm në rast vdekjeje.

6. Primi i sigurimit konsiderohet i paguar ditën kur pagesa është regjistruar në llogarinë e sigurosit.

7. Çdo kërkesë për shtyrjen e pagesës së primit duhet të miratohet me shkrim nga siguroesi.

Neni 8

1. Palët bien dakord për përcaktimin e shumës së sigurimit, në varësi të tarifave të siguruesit, moshës të të siguruarit, gjendjes shëndetësore të të siguruarit dhe periudhës së sigurimit.

Pasojat e mospagesës së primit të sigurimit

Neni 9

1. I siguruari/kontraktuesi i paguan siguroesit primin e sigurimit ndërsa siguroesi pranon pagesën e primit nga ai ose çdo person tjetër i cili ka një interes ligjor që primi të paguhet.
2. Primi për sigurimin shtesë (nëse ka) do të jetë i pagueshëm në të njëjtat afate kohore dhe në të njëjtën monedhë si dhe primi për sigurimin kryesor, përveçse në rastet kur ka pasur kontratë të veçantë.

Neni 10

1. Nëse primi vjetor (primi i dytë e në vazhdim ose kësti i dytë e në vazhdim) nuk është paguar brenda një periudhe 15 ditore nga data e detyrueshme për pagesë sipas pikës 3 të nenit 7, atëherë siguroesi duhet të dërgojë në adresë të të siguruarit/kontraktuesit një njoftim kujtesë lidhur me pagesën e tij.

2. Nëse i siguruari/kontraktuesi edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim nga siguroesi nuk e paguan primin brenda periudhës së përcaktuar në korrespondencën njoftuese, periudhë e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se 30 ditë që nga dita e dërgimit të korrespondencës, atëherë siguroesi ka të drejtë që, nëse janë paguar të paktën 3 (tre) prime vjetore të njoftojë të siguruarin/kontraktuesin që shuma e siguruar do të zvogëlohet sipas tabelës së shumës së kapitalizuar.

3. Shuma e sigurimit të kapitalizuar: Në rast se i siguruari vendos ndërprerjen e kontratës dhe dëshiron të jetë i mbuluar me sigurim atëherë vlera e rezervës matematikore konsiderohet si prim i menjëhershëm i paguar në çastin e ndërprerjes së kontratës dhe në varësi të këtij primi llogaritet një shumë e zvogëluar (kapitalizuar) të cilën i siguruari do ta përfitojë në kohën e llogaritur sipas kontratës.

4. Nëse ngjarja e sigurimit ndodh brenda periudhës së pritjes për pagesën e primit prej minimumi 45 ditësh, atëherë siguroesi duhet t'i paguajë përfituesit shumën e siguruar por pasi të ketë zbritur primet e papaguara.

5. Nëse ngjarja e sigurimit ndodh pas periudhës së pritjes për pagesën e primit prej 45 ditësh, atëherë konsiderohet se shuma e sigurimit është zvogëluar sipas tabelës së shumës së siguruar të zvogëluar para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, me kusht që të jenë paguar të paktën 3 (tre) prime vjetore. Në rast se janë paguar më pak se 3 (tre) prime vjetore, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit dhe i siguruari/kontraktuesi nuk ka të drejtën e marrjes së primeve të paguara.

V. DETYRIMET E SIGURUESIT

Neni 11

1. Siguroesi detyrohet të paguajë përfitimet e pagueshme të përcaktuara në Policën e Sigurimit në mbështetje të këtyre kushteve të përgjithshme në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit si më poshtë vijon:

(1) Në rast vdekjeje të personit të siguar para përfundimit të periudhës së sigurimit;

(2) Në rast mbijetese të të siguarit deri në përfundim të periudhës së sigurimit;

2. Në rastet e dëmshpërblimit për vdekjen si pasojë e një sëmundjeje, siguroesi ka të drejtë të shqyrtojë të dhënat mjekësore e personale të të siguarit.

VI. PËRJASHTIME DHE KUFIZIME TË DETYRIMEVE TË SIGURUESIT

Neni 12

Siguroesi nuk është i detyruar të paguajë të gjithë vlerën e shumës së siguruar të rënë dakord, por vetëm vlerën e rezervës matematikore, konform tabelës së primit të kthyeshëm, në rastet e mëposhtme:

- Nëse i siguruari kryen vetëvrasje ose vdes si pasojë e një përpjekjeje për vetëvrasje gjatë të njëjtës periudhë;
- Nëse përfituesi, apo një trashëgimtar, shkakton me qëllim vdekjen e të siguarit dhe të paktën 3 prime vjetore janë paguar deri në kohën e vdekjes;
- Nëse vdekja e të siguarit vjen si pasojë e veprimeve luftarake, rebelimeve, grevave, trazirave qytetare, terrorizmi, apo përlëshjeve të armatosura;
- Nëse vdekja e të siguarit vjen si pasojë e dënimit me vdekje, ose nëse i siguruari vdes teksa në mënyrë të vetëdijshme po përçatit, kryen apo provon të largohet nga vendngjarja pas kryerjes të një veprimi kriminal;
- Nëse vdekja e të siguarit është pasojë e një tërmeti;
- Nëse vdekja e të siguarit vjen si pasojë e pjesëmarrjes në gara me mjete motorike në tokë, apo në ajër si dhe me mjete sportive profesionale;
- Nëse të dhënat e paraqitura në pyetësorin mbi shëndetin e të siguarit nuk janë të sakta;

8. Nëse vdekja e të siguarit vjen si pasojë e AIDS (Acquired Immune Deficiency Syndrome) apo si pasojë e abuzimit me alkoolin, drogat apo lëndët e tjera narkotike;

9. Nëse ngjarja e sigurimit ndodh si pasojë e përpjekjes për të kryer, apo kryerjes të një aborti jo-spontan dhe të pa këshilluar nga mjeku specialist;

10. Nëse ngjarja e sigurimit ka ndodhur si pasojë e shpërthimit apo rrezatimit bërthamor ose atomik;

11. Nëse vdekja e të siguarit ka ardhur si pasojë e sporteve të rrezikshme (alpinizmi, hedhja me parashutë etj.);

12. Nëse vdekja e të siguarit ndodh si pasojë e qëndrimit në zona klimaterike ekstreme;

13. Nëse vdekja e të siguarit ndodh si pasojë e përdorimit të një avioni, përveçse në rastet e udhëtimit në avion të licencuar për transportin e pasagjerëve.

VII. DETYRIMET E POLICËMBAJTËSIT

Neni 13

1. Pas lidhjes së kontratës së sigurimit të jetës, kontraktuesi/i siguruari detyrohet të vërë në dijeni siguroesin mbi të gjitha faktet dhe rrethanat e rëndësishme për vlerësimin e rrezikut që kontraktuesi/i siguruari i di apo që duhet t'i dinte. Çdo rrethanë mbi të cilën siguroesi ka shtruar një pyetje në kërkesën për sigurim do të quhet rrethanë e rëndësishme në sigurim.

2. Siguroesi ka të drejtë të zgjidhë kontratën nëse kontraktuesi/i siguruari qëllimisht ka paraqitur të dhëna të pasakta, ose qëllimisht ka heshtur mbi fakte që mund të kishin ndikuar mbi vendimin e siguroesit të lidhjen ose jo të kontratës së sigurimit.

3. Në rast se kontrata zgjidhet për shkak të arsyeve të paraqitura në pikën 2 më sipër, atëherë siguroesi ka të drejtë të mbajë primin e sigurimit që i përket periudhës deri në zgjidhjen e kontratës.

4. E drejta e siguroesit për të kërkuar zgjidhjen e kontratës përfundon nëse tre muaj pasi ka mësuar për paraqitjen e pasaktë, apo mosparaqitjen e fakteve nuk e ka vënë në dijeni kontraktuesin/të siguarin mbi vendimin për të përdorur të drejtën e zgjidhjes së kontratës.

5. Nëse kontraktuesi/i siguruari ka paraqitur pasaktësisht një të dhënë por nuk e ka bërë me qëllim, siguroesi mundet që brenda një muaji nga vënia në dijeni për pasaktësinë apo mosparaqitjen e faktit, të njoftojë se do të zgjidhë kontratën apo të propozojë një prim sigurimi shtesë sipas një rreziku më të lartë.

6. Në këtë rast, kontrata do të përfundojë 15 ditë pasi siguroesi ta vërë në dijeni kontraktuesin/të siguarin mbi përfundimin, ndërsa në rast se siguroesi propozon prim shtesë atëherë kontrata do të përfundojë kur kontraktuesi/i siguruari nuk e ka pranuar propozimin brenda 15 ditëve që nga data e marrjes së njoftimit.

7. Nëse ngjarja e sigurimit ndodh para përcaktimit të pasaktësisë apo mosparaqitjes të të dhënave, apo pas përcaktimit të pasaktësisë por përpara përfundimit të kontratës apo nënshkrimit të një kontrate mbi primin shtesë, atëherë shuma e siguruar do të zvogëlohet në përpesëtim me primin e papaguar duke marrë parasysh rrezikun e vërtetë.

VIII. DEKLARIMI I PASAKTË I MOSHËS SË TË SIGURUARIT

Neni 14

1. Kontrata e sigurimit të jetës do të jetë e pavlefshme dhe siguroesi detyrohet të kthejë primin e paguar nëse në çastin e lidhjes së kontratës, mosha e të siguarit është paraqitur pasaktësisht dhe mosha e vërtetë e të siguarit është jashtë limitit maksimal të moshës për sigurimin e jetës të përcaktuar nga siguroesi.

2. Nëse mosha e të siguarit është paraqitur më e vogël se mosha e vërtetë dhe mosha e vërtetë nuk është përtej limitit të sigurimit, atëherë kontrata do të jetë e vlefshme dhe shuma e siguruar do të përcaktohet në varësi të moshës së vërtetë të të siguarit në datën e fillimit të sigurimit.

3. Nëse i siguruari është më i ri sesa është paraqitur në kontratë, atëherë primi do të zvogëlohet përkatësisht dhe siguroesi do të kthejë diferencën midis primit të paguar dhe primit të saktë.

4. Kontraktuesi/I Siguruari ka të drejtë t'i kërkojë siguroesit rritjen e shumës së siguruar përkatësisht sipas moshës së saktë të të siguarit.

IX. TË DREJTA E POLICËMBAJTËSIT PARA NDODHJES SË NGJARJES SË SIGURIMIT

DORËZIMI I POLICËS SË SIGURIMIT

Neni 15

1. Kontraktuesi/ I Siguruari mund të kërkojë kapitalizim të shumës së sigurimit pa pagesë të mëtejshme të primit me shumë sigurimi të zvogëluar sipas tabelës së shumës së sigurimit të zvogëluar (kapitalizuar). Kapitalizimi i shumës së sigurimit është i mundur gjatë gjithë periudhës së sigurimit nëse është paguar primi i sigurimit për të paktën 3 vite të njëpasnjëshme.

2. Siguroesi ka të drejtë t'i ofrojë kontraktuesit/të siguarit vlerën e primit të kthyeshëm sipas tabelës përkatëse, nëse gjatë periudhës së sigurimit ka rrethana që vështirësojnë pagesën e detyrimeve nga njëra prej palëve, me kusht që primi i sigurimit të jetë paguar për 3 (tre) vite rresht. Në këtë rast detyrimet e siguroesit përfundojnë në orën 00:00 të ditës kur paguhet vlera e primit të kthyeshëm dhe dorëzohet policja e sigurimit.

X. PËRDORIMI I POLICËS SI PENG

Neni 16

1. Një policë sigurimi jete mund të përdoret si peng në rast huamarrjeje.
2. Vendosja e policës si peng për një hua është e vlefshme për siguruesin vetëm nëse vihet në dijeni me shkrim që policia është vendosur peng me një huamarrës të përcaktuar.

XI. RINOVIMI I KONTRATËS SE SIGURIMIT

Neni 17

1. Sigurimi i jetës që është përfunduar para kohës së përcaktuar në policë, apo që është shëndërruar me shumë sigurimi të kapitalizuar, mund të ripërterihet me anë të një kërkesë me shkrim nga kontraktuesi/i siguruari brenda dymbëdhjetë muajve nga përfundimi i muajit të fundit për të cilin është paguar primi.
2. Detyrimi i siguruesit për rinovimin e policës fillon në orën 24:00 të ditës kur ka vërtetuar me shkrim pranimin e kërkesës për rinovim të sigurimit me kusht që të gjitha primet e prapambetura të jenë paguar dhe gjendja shëndetësore e të siguruarit të jetë e pranueshme për sigurim. Siguruesi do të pranojë apo refuzojë kërkesën për rinovim minimalisht brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës për rastet e marrjes në sigurim pa kontroll mjekësor dhe 30 ditësh për rastet e marrjes në sigurim me kontroll mjekësor.
3. Nëse kërkesa për rinovim i dorëzohet siguruesit brenda 3 muajve nga muaji i fundit i pagesës së primit, atëherë siguruesi do ta pranojë kërkesën duke plotësuar një pyetësor të ri shëndetësor.
4. Nëse kërkesa për rinovim është dorëzuar pas 3 muajve nga muaji i fundit i pagesës së primit atëherë siguruesi ka të drejtë të kërkojë kryerjen e kontrollit mjekësor të të siguruarit/siguruarve.
5. Nëse i siguruari vdes brenda 1 viti nga rinovimi i sigurimit për shkak sëmundjeje të cilën e ka fshehur gjatë paraqitjes së kërkesës për rinovim, dhe sëmundja është e asaj natyre që siguruesi nuk do të e pranonë në sigurim, siguruesi paguan vetëm shumën e zvogëluar të rënë dakord sipas tabelës së shumave të kapitalizuar të sigurimit pa pagesën e mëtejshme të primit (kapitalizimit), pa marrë parasysh primet për rinovimin e kontratës, me kusht që primi të jetë paguar në përputhje me nenin 15 paragrafi (2) të këtyre kushteve të përgjithshme. Nëse primi nuk është paguar për 3 (tre) vite sipas parashikimeve të nenit 15 paragrafi 2 të këtyre kushteve të përgjithshme, atëherë nuk ekziston detyrim për siguruesin.

XII. PJESËMARRJA NË FITIM

Neni 18

1. Përfituesi do të ketë të drejtë të marrë pjesë në fitimin e realizuar të siguruesit nëse kjo është përcaktuar në kushtet e veçanta.
2. Si fitim i realizuar konsiderohet fitimi që siguruesi mund t'i shtojë shumës së rënë dakord dhe që del nga mjetet në dispozicion të siguruesit. Vlera dhe mënyra e pjesëmarrjes në fitim konfirmohen me vendim të veçantë të siguruesit.
3. E drejta e pjesëmarrjes në ndarjen e fitimit të realizuar të siguruesit në sigurimin e jetës përfitohej me përfundimin e afatit prej 24 (njëzetë e katër) muajsh nga data e fillimit të sigurimit me kusht që primi të jetë paguar i plotë.
4. Pjesëmarrja në fitim llogaritet në datën 31 dhjetor të çdo viti dhe për këtë policëmbajtësi njoftohet gjatë vitit pasardhës, nëse përfundon afati sipas paragrafit 3 të këtij neni dhe nëse siguruesi merr vendim lidhur me paragrafin (2) të këtij neni.
5. Për mbijetesën, pjesëmarrja në fitim paguhet së bashku me shumën e sigurimit.

XIII. E DREJTA E SIGURUESIT PËR TË KËRKUAR RIMBURSIM TË DËMSPËRBLIMIT TË PAGUAR

Neni 19

1. Siguruesi pasi ka paguar shumën e sigurimit në favor të të siguruarit apo përfituesit, ka të drejtën për të kërkuar rimbursim të dëmshpërblimit nga një palë e tretë shkaktare e ngjarjes së sigurimit deri në vlerën e shumës së paguar si dëmshpërblim si dhe, në rast se ka, shpenzimet e nevojshme gjyqësore apo shtesa të tjera. I siguruari/përfituesi i cili ka marrë dëmshpërblimin nga siguruesi nuk ka të drejtë ta kërkojë atë edhe nga një palë e tretë shkaktare e dëmit.

XIV. TË DREJTAT MBI SIGURIMIN E JETËS

Neni 20

1. Të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kontrata e sigurimit i përkasin kontraktuesit/të siguruarit deri në ndodhjen e ngjarjes së sigurimit.
Për produktin "Karta e besnikërisë" të drejtat që rrjedhin nga kontrata e sigurimit i përkasin vetëm kontraktuesit deri në ndodhjen e ngjarjes së sigurimit.
2. Nëse përfituesi vdes para se të ndodhë ngjarja e sigurimit, atëherë përfitimet sipas kësaj kontrate nuk i përkasin trashëgimtarëve të tij, por përfituesve të tjerë dhe nëse nuk janë përcaktuar përfitues të tjerë i paguhen vetë të siguruarit dhe nëse ky ka vdekur trashëgimtarëve ligjorë të të siguruarit ose me testament.
3. Të drejtën e përfitimit të shumës së sigurimit përfituesi mund të kërkojë t'ia transferojë një personi tjetër edhe para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, por për këtë është e nevojshëm miratimi me shkrim i kontraktuesit/të siguruarit. Ky miratim duhet të përmbajë identitetin e personit të cilit i transferohet (kalohet) e drejta.

4. Në çdo rast transferimi i të drejtës mund të kryhet vetëm me miratimin me shkrim të siguruesit.

XV. NGJARJA E SIGURIMIT

Neni 21

1. Përfituesi ose i siguruari detyrohet që me ndodhjen e rastit të sigurimit të njoftojnë me shkrim siguruesin brenda 7 ditësh nga dita e ngjarjes.
2. Njoftimi bëhet me formularin përkatës të siguruesit dhe bashkë me të paraqiten dokumentet e mëposhtme:
 - Originali i policës së sigurimit të jetës dhe të kartës personale të sigurimit;
 - Kopje të dokumentit të identifikimit;
 - Certifikatën e vdekjes ose dokument tjetër që vërteton vdekjen e të siguruarit;
 - Raporti mjekësor për kohën, shkaqet e vdekjes, etj.;
 - Epikrizë mjekësore nga mjeku që e ka kuruar ose mjekuar të ndjerin;
 - Dëshmi trashëgimie nëse si përfitues të policës janë përcaktuar trashëgimtarët e ligjshëm;
 - Prova për lidhje familjare nëse nuk janë përcaktuar përfitues.
3. Siguruesi ka të drejtë të kërkojë dhe prova të tjera të nevojshme për vërtetimin e të drejtës për pagesë.
4. Shpenzimet që kanë të bëjnë me njoftimin e ngjarjes së sigurimit janë në ngarkim të personit që bën njoftimin.

XVI. PAGESA E SHUMËS SË SIGURIMIT

Neni 22

1. Siguruesi paguan shumën e sigurimit në përputhje me kontratën brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita që ka marrë njoftimin e ngjarjes së sigurimit me të gjithë dokumentet dhe provat e parashikuara në nenin 21, paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtyre kushteve të përgjithshme. Në marrëveshje me të siguruarin/përfituesin, siguruesi mund të paguajë vlerën e shumës së siguruar në përfundim të vitit sigurues, pavarësisht nga afati 30 ditor i përmendur më sipër. Forma dhe mënyra e tërheqjes së shumës së siguruar nga i Siguruari/Përfituesi përcaktohen me marrëveshje të veçantë midis palëve.
2. Si përjashtim, nëse për konfirmimin e ngjarjes së sigurimit, detyrimin e siguruesit dhe masën e detyrimit, është e nevojshme një periudhë kohe, pra në se nuk mund të vërtetohet baza për ekzistencën e detyrimit të siguruesit ose masën e pagesës, afati sipas paragrafit (1) të këtij neni fillon prej datës së vërtetimit të bazës së detyrimit dhe shumës së tij.
3. Siguruesi në çdo rast duhet të paguajë me kërkesë të personit të autorizuar pjesën e pakontestuar nga detyrimi i tij për llogari të shumës së përgjithshme, nëse nuk ka mundësi të përcaktojë detyrimin e përgjithshëm për pagesë në afatin e caktuar në paragrafin (1) të këtij neni.
4. Nëse në momentin e përcaktimit të detyrimit ekziston kundërshti rreth zbatimit të rregullave tatimore dhe rregullave të tjera me të cilat përcaktohen taksat e detyrueshme, siguruesi do të veprojë në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni.
5. Nëse siguruesi nuk e paguan kompensimin në afatet dhe mënyrën e parashikuar nga paragrafi (1), (2) e (3), me përjashtim të rasteve kur ka rënë dakord me të siguruarin/përfituesin, duhet që për pagesat e vonuara të paguajë kamatë vonesë sipas ligjit.
6. Në rast se përfituesi nuk është përcaktuar nga kontraktuesi/i siguruari, siguruesi i paguan shumën e sigurimit personit që gëzon këtë të drejtë në bazë të dispozitave ligjore mbi trashëgiminë. Në këtë rast, siguruesi lirohet nga detyrimi i kontratës nëse në momentin e pagesës nuk ka ditur dhe nuk ka mundur të dijë se përfituesi është përcaktuar me testament ose me ndonjë akt tjetër i cili nuk i është paraqitur. Përfituesi ka të drejtë të kërkojë kthimin e pagesës nga personi i cili ka marrë shumën e sigurimit nga siguruesi. E njëjta vlen edhe në rast të ndryshimit të përfituesit.
7. Siguruesi ka të drejtë të zbrësë pjesët e papaguara të primit nga çdo pagesë që bën në bazë të kontratës së sigurimit.
8. Siguruesi kërkon që para pagesës së shumës së sigurimit të nënshkruhet një deklaratë nga i siguruari/përfituesi në të cilën konfirmohet plotësimi i detyrimit.

XVII. PËRCAKTIMI I PËRFITUESIT

Neni 23

1. Kontraktuesi/i siguruari përcakton në kontratë përfituesin e shumave të pagueshme që rrjedhin nga kontrata. Në të kundërt, zbatohen dispozitat e Ligjeve të aplikueshme në Kosovë.
Për produktin "Karta e besnikërisë", përfitues në rast mbijetese mund të jetë vetë i siguruari ose çdo person tjetër i caktuar prej tij. Përfitues në rast vdekjeje mund të jetë çdo person i caktuar prej të siguruarit. Në rast se nuk janë përcaktuar përfitues, zbatohen dispozitat e ligjeve të aplikueshme në Kosovë.
2. Nëse përfituesi është nën 18 vjeç atëherë shuma e sigurimit do t'i paguhet prindërve apo kujdestarëve ligjorë.
3. Në rast se përcaktohet "bashkëshorti" si përfitues, atëherë përfitimi i takon personit që

është në lidhje martesore me të siguruarin në kohën e vdekjes.

4. Nëse polica përcakton "fëmijët", "trashëgimtarët" apo "pasardhësit" si përfitues dhe policëmbajtësi nuk e ka përcaktuar sesi do të ndahet përfitimi atëherë pjesa e secilit do të jetë në përpjesëtim me pjesën e trashëgimisë të parashikuar në testament, edhe nëse kanë hequr dorë nga pjesa e tyre. Në rast të mungesës edhe të testamentit, pjesët për të marrë shumën e sigurimit të përfituesve të sipërpërmendur do të prezumohen se janë të barabarta.

5. Përfituesi do të jetë i vetmi që do të ketë të drejtë të marrë shumën e sigurimit pavarësisht se kur apo si është përcaktuar si përfitues dhe pavarësisht nëse ka dhënë apo jo miratimin e tij para vdekjes të të siguruarit, në mënyrë që të mund t'i drejtohet siguresit me një kërkesë për pagesën e shumës së sigurimit.

XVIII. LËSHIMI I POLICËS ZËVENDËSUESE

Neni 24

1. Në rast humbjeje të policës së sigurimit atëherë kontraktuesi/i siguruari, detyrohet të njoftojë menjëherë siguresin për humbjen e saj.
2. Siguruesi do të lëshojë një kopje të saj kundrejt paraqitjes së kartës personale të sigurimit të jetës së të siguruarit dhe kundrejt lëshimit të një deklarate noteriale nga kontraktuesi/i siguruari, ku deklarohet se polica e sigurimit ka humbur dhe nuk është përdorur për ndonjë qëllim tjetër. E njëjta procedurë do të ndiqet edhe në rast humbje të kartës personale të sigurimit të jetës.
3. Të gjitha shpenzimet e nevojshme për lëshimin e policës zëvendësuese apo të kartës personale të sigurimit të re, do të përballohen nga kontraktuesi/i siguruari

XIX. PAGESA E DETYRIME TË TJERA

Neni 25

1. Siguruesi gëzon të drejtën që t'i kërkojë kontraktuesit/të siguruarit të paguajë për të gjitha shërbimet që ky i fundit kërkon në veçanti nga siguruesi. Pagesa për shërbimet do të jetë një vlerë e përcaktuar nga siguruesi.
2. Përfituesi/i siguruari detyrohet të paguajë të gjitha detyrimet e parashikuara në legjislacionin tatimor në fuqi.

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 26

1. Kontraktuesi/i siguruari, me një deklaram ose me një veprim të qartë pohues, shprehë pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të;
2. Siguruesi ka për detyrë informimin, njoftimin dhe udhëzimin që SIGAL Life UNIQA do të mbledhë, ruajë, përpunojë dhe transferojë të dhënat e kontraktuesit/te siguruarit personale në formë elektronike dhe/ose të shtypur vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe vetëm për kohëzgjatjen e kërkuar me legjislacionin përkatës në fuqi.

XX. NDRYSHIME

Neni 26

Këto kushte të përgjithshme të sigurimit mund të zëvendësohen apo të ndryshohen me miratimin e një aktuari, dhe pas vënies në dijeni të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, ndryshime për të cilat kontraktuesi/i siguruari duhet të njoftohet plotësisht e saktësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi.

XXI. JURIDIKSIONI DHE MONEDHA

Neni 27

1. Autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve të kontratës së sigurimit është Gjykata e Rrethit Prishtine, përveç rasteve kur është vendosur ndryshe.
2. Monedha për të gjitha veprimet e parashikuara në këtë kontratë është monedha në të cilën përcaktohet dhe llogaritet shuma e sigurimit.

XXII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 28

Për çdo rregullim të marrëdhënieve midis siguresit, të siguruarit, kontraktuesit, përfituesit dhe personave të tjerë, për të cilët nuk shprehen këto kushte, janë të zbatueshme parashikimet e ligjeve të aplikueshme në Kosovë.